<p style="text-align: center;">Neni 87 Ushtrimet ditore dhe qëndrimi jashtë hapësirës të mbyllur</p> <p>1. I mituri ka të drejtë që të ushtrojë në mënyrë të mjaftueshme për të ruajtur shëndetin dhe të kalojë së paku tri (3) orë jashtë hapësirës së mbyllur gjatë kohës së lirë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 87 Daily Exercise and Staying Outside Closed Premises</p> <p>1. A juvenile has the right to exercise sufficiently in order to remain healthy and to spend at least three (3) hours daily outside closed premises during free time.</p>	<p style="text-align: center;">Član 87 Dnevne vežbe i boravak van zatvorenog prostora</p> <p>1. Maloletnik ima pravo da dovoljno vežba u cilju očuvanja zdravlja kao i da provede najmanje tri (3) sata dnevno van zatvorenih prostorija u slobodno vreme.</p>

<p>2. Të miturit i garantohet një ambient i sigurt për t'u marrë me sport, për të ushtruar dhe për aktivitete të tjera fizike.</p> <p>3. Për të ushtruar mbikëqyrjen e vazhduar disiplinore, të miturve u ndaloheq të largohen nga territori i institucionit edukativo-korrektues, përveq rasteve kur parashihet ndryshe me rregullat e brendshme të institucionit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 88 Arsimimi</p> <p>Çdo i mitur moshës së detyrueshme për shkollim ka të drejtë për arsim të përshtatshëm për nevojat dhe aftësitë dhe të përcaktuara për përgatitjen e tij apo të saj për kthim në shoqëri. Kurdo që është e mundur, arsimi i tillë duhet të sigurohet jashtë objekteve të privimit nga liria, në shkollat e komuës dhe, në çdo rast, me arsimtarë të kualifikuar përmes programeve të integruara në sistemin arsimor ashtu që pas lirim, të miturit të mundën që pa pengesë të vazhdojnë arsimin e tyre. Vëmendje e posaçme duhet kushtuar për arsimin e të miturve me origjinë të huaj apo me nevoja të veçanta kulturore apo etnike. Të miturit të cilët janë analfabetë apo kanë vështirësi në të nxënë duhet të gëzojnë të drejtën në arsim special.</p>	<p>2. A juvenile shall have a secured environment for playing sports, exercising and other physical activities.</p> <p>3. To exercise continuous disciplinary surveillance, the juveniles shall be prohibited to leave the territory of the educational-correctional institution, unless otherwise regulated by internal rules of the institution.</p> <p style="text-align: center;">Article 88 Education</p> <p>Any juvenile of mandatory education age shall be entitled to appropriate education for his needs and skills and for his or her preparation to return to the society. Whenever possible, such education shall be provided outside detention facilities, at municipality schools and, in any case, with qualified teachers through integrated programmes in the education system so after release, the juveniles would be able to continue their education without obstacles. Special attention shall be paid to education of juveniles of foreign origin or with special cultural and ethnic needs. The juveniles that are illiterate or that have learning difficulties shall be entitled to special education.</p>	<p>2. Maloletniku se garantuje bezbedno okruženje za bavljenje sportom, vežbanje i druge fizičke aktivnosti.</p> <p>3. Za sprovođenje neprestane disciplinske kontrole, maloletnicima se zabranjuje da napuštaju prostorije vaspitno-popravne ustanove, osim za slučajeve kada je drugačije predviđeno internim pravilima ustanove</p> <p style="text-align: center;">Član 88 Obrazovanje</p> <p>Svaki maloletnik obaveznog školskog uzrasta ima pravo na obrazovanje u skladu sa svojim potrebama i mogućnostima koje je dizajnirano da njega ili nju pripreme za povratak u društvo. Kad god je moguće, takvo obrazovanje treba da bude obezbeđeno van prostorija i objekata u okviru ustanove, u opštinskim školama, u svakom slučaju, sa kvalifikovanim nastavnicima u okviru programa integrisanih sa obrazovnim sistemom, tako da nakon oslobađanja, maloletnici imaju pravo na nesmetan nastavak školovanja. Posebnu pažnju treba posvetiti obrazovanju maloletnika stranog porekla ili sa posebnim kulturnim i etničkim poreklom. Maloletnici koji su nepismeni ili imaju poteškoće u učenju imaju pravo na specijalno obrazovanje.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 89 Vizitat</p> <p>1. I mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në javë minimum deri në një (1) orë nga prindi i tij, prindi adoptues, kujdestari, bashkëshorti, fëmija, fëmija i adoptuar dhe nga të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt.</p> <p>2. I mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në muaj nga persona të tjerë të cilët nuk ndikojnë negativisht në ekzekutimin e masës.</p> <p>3. Drejtori i institucionit edukativo-korrektues ka autorizimin për të ndaluar vizitat për shkaqe të justifikueshme në pajtim me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Drejtësisë</p>	<p style="text-align: center;">Article 89 Visits</p> <p>1. A juvenile shall have the right to receive a visit at least once each week for a minimum of one (1) hour by his parent, adoptive parent, guardian, spouse, child, adopted child, and other relatives by blood in a direct line or in a collateral line to the fourth degree.</p> <p>2. A juvenile shall have the right to receive a visit at least once per month by other persons who will not have a negative influence on execution of the measure.</p> <p>3. The director of the educational-correctional institution has the authority to prohibit visits for justified reasons in accordance with a sub-legal act issued by the Ministry of Justice.</p>	<p style="text-align: center;">Član 89 Posete</p> <p>1. Maloletnik ima pravo da najmanje jednom nedeljno u trajanju od najmanje jednog (1) sata prima posete roditelja, usvojitelja, supružnika, staratelja, deteta, usvojenika i drugih rođaka u pravoj krvnoj liniji ili pobočnoj liniji do četvrtog stepena.</p> <p>2. Maloletnik ima pravo da najmanje jednom (1) mesečno prima posete drugih lica koja ne utiču negativno na izvršavanje mere.</p> <p>3. Direktor vaspitno-popravne institucije je ovlašćen da zabrani posete iz opravdanih razloga u skladu sa podzakonskim aktom donetim od strane Ministarstva Pravde.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 90 Pushimet</p> <p>1. I mituri ka të drejtë në pushim ditor dhe javor në pajtim me dispozitat e përgjithshme të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.</p> <p>2. I mituri ka të drejtë të shfrytëzimit të pushimeve në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, pas mbajtjes së 1/3 të masës institucionale.</p>	<p style="text-align: center;">Article 90 Leave</p> <p>1. A juvenile has the right to daily and weekly rest in accordance with the general provisions of Law on Execution of Penal Sanctions.</p> <p>2. A juvenile has the right to vacation as specified in paragraph 1 of this Article, after spending 1/3 of the institutional measure.</p>	<p style="text-align: center;">Član 90 Odmor</p> <p>1. Maloletnik ima pravo na dnevni i nedeljni odmor u skladu sa opštim odredbama Zakonika o izvršenju krivičnih sankcija.</p> <p>2. Maloletnik ima pravo da koristi odmor u smislu paragrafa 1 iz ovog člana, nakon održavanja 1/3 institucionalne mere.</p>

<p>3. Drejtori i institucionit edukativo-korrektues të miturit mund t'i lejojë pushim shtesë nga institucioni edukativo-korrektues për arsye edukative, profesionale, familjare ose arsye të tjera sociale deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë çdo vit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 91 Procedurat disiplinore</p> <p>1. Dispozitat mbi procedurat disiplinore dhe dënimet të zbatueshme për personat e dënuar me burgim të paraparë në Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale zbatohen përshtatshmërisht për të miturin i cili i nënshtrohet masës së dërgimit në institucionin edukativo korrektues, nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë Kod.</p> <p>2. Të miturit nuk i shqiptohet veçimi në qeli të veçantë si dënim disiplinor.</p> <p>3. I mituri mund të vendoset në njësi të veçantë të institucionit edukativo-korrektues si dënim disiplinor nën kushtet vijuese:</p> <p>3.1. periudha e vendosjes në njësinë e veçantë nuk mund të kalojë pesëmbëdhjetë (15) ditë;</p>	<p>3. The director of the educational-correctional institution may grant a juvenile additional leave from the educational-correctional institution on educational, occupational, family and other social grounds for a maximum of fifteen (15) days each year.</p> <p style="text-align: center;">Article 91 Disciplinary Procedures</p> <p>1. The provisions on the disciplinary procedures and punishments applicable to persons sentenced to imprisonment set forth in the Law on Execution of Penal Sanctions shall apply mutatis mutandis to a juvenile subject to a measure of committal to an educational-correctional institution, unless this Code specifies otherwise</p> <p>2. A juvenile may not be subject to solitary confinement as a disciplinary punishment.</p> <p>3. A juvenile may be accommodated in a special unit of the educational-correctional institution as a disciplinary punishment under the following conditions:</p> <p>3.1.the period of accommodation in a special unit may not exceed fifteen (15) days;</p>	<p>3. Direktor vaspitno-popravne institucije može da odobri maloletniku dodatno odsustvo iz vaspitno-popravne ustanove zbog obrazovnih, stručnih, porodičnih i drugih socijalnih razloga u trajanju od najviše petnaest (15) dana godišnje.</p> <p style="text-align: center;">Član 91 Disciplinski postupak</p> <p>1. Odredbe o disciplinskim postupcima i kaznama koje se primenjuju na lica osuđena na kaznu zatvora iz Zakonika o izvršenju krivičnih sankcija, primenjuju se uz odgovarajuća prilagođavanja na maloletnika kojem je izrečena mera upućivanja u vaspitno-popravnu instituciju, ako drugačije nije predviđeno u ovom Zakoniku.</p> <p>2. Maloletniku ne sme da bude izrečeno smeštanje u samicu kao disciplinska kazna.</p> <p>3. Maloletniku kao disciplinska kazna može da bude izrečeno smeštanje u posebnu jedinicu vaspitno-popravne ustanove pod sledećim uslovima:</p> <p>3.1. trajanje boravka u posebnoj jedinici ne sme da bude duže od petnaest (15) dana;</p>
---	--	--

<p>3.2. i mituri nuk vendoset i vetëm në njësinë e veçantë, përveç në raste të dhunës ekstreme apo sjelljeve të rrezikshme që ndikojnë në realizimin e planit të edukimit të të miturit. Gjatë kësaj periudhe, e cila nuk mund të jetë më gjatë se (dyzetë e tetë) 48 orë, i mituri mbikqyrët nga psikologu dhe sipas nevojës i ofrohet ndihmë apo këshilla të nevojshme;</p> <p>3.3. i mituri ka të drejtën të kalojë së paku tri (3) orë jashtë lokaleve të mbyllura gjatë kohës së lirë, në përputhje me nenin 87 të këtij Kodi dhe të pranoj vizita në përputhje me nenin 89 të këtij Kodi</p> <p>3.4. i mituri ka qasje në tekste mësimore dhe libra dhe literaturë tjetër në gjuhën të cilin ai e kupton, dhe e cila nuk mund të ketë ndikim të dëmshëm në edukimin e tij;</p> <p>3.5. i mituri vizitohet nga zyrtari mjekësor dhe edukatori një (1) herë në ditë dhe dy (2) herë në javë nga drejtori i institucionit edukativo-korrektues.</p>	<p>3.2. the juvenile shall not be accommodated alone in the special unit, save the cases of extreme violence or dangerous behaviour that impact performing of the juvenile's education programme. During this period, which may not be longer than (forty-eight) 48 hours, the juvenile shall be supervised by the psychologist and as required assistance and necessary advice shall be provided.</p> <p>3.3. the juvenile shall be entitled to exercise his right to spend at least three (3) hours daily outside closed premises during free time in accordance with Article 87 of the present Code and to receive visits according to Article 89 of the present Code.</p> <p>3.4. the juvenile shall have access to textbooks and other books and literature in the language he understands, and which shall not have harmful impact to his education; and</p> <p>3.5. the juvenile shall be visited by a medical officer and educator once a day and by the director of the educational-correctional institution twice a week.</p>	<p>3.2. maloletnik ne sme da boravi sam u posebnoj jedinici, osim u slučajevima ekstremnog nasilja ili opasnog ponašanja koje utiče na sprovođenje plana edukacije maloletnika. Tokom ovog perioda, koji ne može biti duži od 48 (četrdeset osam) sati, maloletnik je pod nadzorom psihologa i ima neophodnu pomoć ili savet ako su mu potrebni;</p> <p>3.3. maloletnik ima pravo da provede najmanje tri (3) sata dnevno van zatvorenih prostorija u toku slobodnog vremena, shodno članu 87 ovog Zakonika, i da prima posete shodno članu 89 ovog Zakonika;</p> <p>3.4. maloletnik ima pristup udžbenicima, drugim knjigama i književnim delima na jeziku koji on/ona razumeju a koja ne bi mogla imati štetan uticaj na njegovo obrazovanje; i</p> <p>3.5. maloletnika jednom (1) dnevno posećuje lekar i vaspitač, kao i direktor vaspitno-popravne ustanove dva (2) puta nedeljno.</p>
--	---	---

<p>3.6.i mitur mund të vendoset në njësi të veçantë nëse ekziston rrezik i drejtpërdrejtë për lëndim fizik të vetes ose dhunë ndaj personave të tjerë dhe qetësimi verbal nuk ka qenë i mjaftueshëm.</p> <p>3.7.lidhur me vendosjen në njësi të veçantë, regjistron informatat në vijim: arsyeja për vendosje në njësi të posaçme; koha e fillimit dhe e mbarimit të vendosjes në njësi të posaçme; emri i të punësuarit të institucionit nën mbikëqyrjen e të cilit i mituri qëndron në njësi të posaçme; njoftimi i mjekut lidhur me gjendjen shëndetësore të të miturit.</p> <p>4. Drejtori i institucionit ose personi i autorizuar nga ana e drejtorit e njofton prindin, prindin adoptues apo kujdestarin lidhur me vendosjen e të miturit në njësi të veçantë menjëherë pas nxjerrjes që vendimit përkatës.</p> <p>5. Të gjitha gjërat të cilat mund t'i shfrytëzojë i mituri për ta rrezikuar jetën dhe shëndetin e tij konfiskohen nga i mituri i cili është i vendosur në njësi të veçantë.</p> <p>6. I mituri i cili është i vendosur në njësinë e veçantë duhet të jetë nën mbikëqyrje të vazhdueshme të një të punësuarit të institucionit.</p>	<p>3.6.the juvenile may be placed in a separate ward if there is a direct danger of physical injury of himself or violence against other persons and the verbal comfort was not sufficient.</p> <p>3.7.in regards to placing him in the separate ward, the following information shall be registered: the reason for placement on the separate ward; time of the beginning and end of the placement in separate ward; name of the employee in the institution under whose surveillance the juvenile stays in the separate ward; notification of the doctor on the health situation of the juvenile.</p> <p>4. The Director of the institution or person authorized by the Director shall notify the parent, adoptive parent or guardian in regards to the placement of the juvenile in a separate ward immediately after issuance of the relevant decision.</p> <p>5. All items that may be used by the juvenile to endanger his life and health shall be confiscated from the juvenile who is placed in a separate ward.</p> <p>6. The juvenile that is placed in a separate ward shall be under continuous surveillance of an employee of the institution.</p>	<p>3.6.maloletnik se može postaviti u posebnu jedinicu ako postoji neposredna opasnost od fizičke povrede prema sebi ili nasilja prema drugim osobama i verbalno umirivanje nije bilo dovoljno.</p> <p>3.7.prilikom smeštanja u posebnu jedinicu beleže se sledeće informacije: razlog za smeštanje u specijalnim jedinicama; vreme početka i kraja trajanja smeštaja u specijalnim jedinicama; ime zaposlenog iz institucije pod čijim nadzorom maloletnik ostaje u specijalnim jedinicama; najava lekara o zdravstvenom stanju deteta.</p> <p>4.Direktor ustanove ili lice koje ovlasti direktor mora da obavesti roditelja, usvojioca ili staraoca u pogledu smeštaja maloletnih lica u posebnu jedinicu odmah nakon izdavanja odgovarajuće odluke.</p> <p>5. Sve predmete koje maloletnik može da koristi za ugrožavanje svog života i zdravlja se uklanjaju i oduzimaju od maloletnika koji se nalazi u posebnoj jedinici.</p> <p>6. Maloletnik koji se nalazi u posebnoj jedinici treba da bude pod stalnim nadzorom jednog od zaposlenih u instituciji.</p>
--	--	--

<p>7. I mituri i cili vendoset në njësi të veçantë ka të drejtë të takohet me prindin , prindin adoptues apo kujdestarin;</p> <p>8. Pas përfundimit të qëndrimit të të miturit në njësi të veçantë, psikologu i institucionit, drejtori i institucionit ose personi i autorizuar nga drejtori bisedojnë me të miturin për t'i identifikuar arsyet e sjelljes së të miturit të cilat kanë pasur për pasojë vendosjen e tij në njësi të veçantë dhe t'i marrin parasysh rezultatet e bisedës gjatë procesit të arsimimit të të miturit në të ardhmen.</p>	<p>7. The juvenile that is placed in a separate ward shall be entitled to meet with his parent, adoptive parent or guardian;</p> <p>8. After completion of the staying of juvenile in a separate ward, the psychologist of the institution, director of the institution or the person authorized by the director shall talk with the juvenile to identify the reasons for the juvenile's conduct which resulted with his placement in a separate ward and the results of the talks shall be taken into account during the process of education of the juvenile in the future.</p>	<p>7. Maloletnik koji se nalazi u posebnoj jedinici ima pravo da se sastaje sa roditeljem, roditeljem usvojiocem ili starateljem;</p> <p>8. Po završetku boravka maloletnika u posebnoj jedinici, psiholog u instituciji, direktor institucije ili lice koje on ovlasti razgovoraju sa maloletnikom da identifikuju razloge za ponašanje maloletnika koje su prouzrokovale njegov boravaka u posebnoj jedinici i uzeti u obzir rezultate razgovora tokom vaspitavanja maloletnika u budućnosti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 92 Ekzekutimi i masës së dërgimit në institucionin për kujdes të posaçëm shëndetësorë</p>	<p style="text-align: center;">Article 92 Execution of Measure of Committal to a Special Health Care Facility</p>	<p style="text-align: center;">Član 92 Izvršavanje mere upućivanja u ustanovu sa posebnim zdravstvenim staranjem</p>
<p>1. I mituri të cilit i është shqiptuar masa edukative e dërgimit në institucionin e kujdesit të posaçëm shëndetësor për shkak të çrregullimeve mendore dërgohet në institucionin e kujdesit të posaçëm shëndetësor.</p> <p>2. Me kërkesë të Shërbimit Sprovues, policia shoqëron të miturin në institucionin e kujdesit të posaçëm shëndetësor.</p> <p>3. Nëse ekzekutimi i masës edukative e dërgimit në institucionin e kujdesit të posaçëm shëndetësor nuk mund të fillojë ose</p>	<p>1. A juvenile sentenced to the educational measure of committal to a special health care facility due to mental disorder shall be sent to an appropriate special health care facility.</p> <p>2. By the request of the Probation Service, the Police will escort the juvenile to the institution of special health care facility.</p> <p>3. If execution of the educational measure of committal to a special health</p>	<p>1. Maloletnik kojem je izrečena vaspitna mera upućivanja u ustanovu za posebno zdravstveno staranje zbog mentalnog poremećaja se šalje u ustanovu sa posebnim zdravstvenim staranjem.</p> <p>2. Na zahtev Probacione službe, policija prati maloletnika u instituciju sa posebnim zdravstvenim staranjem.</p> <p>3. Ako izvršenje vaspitne mere ne može da otpočne ili bude nastavljeno zbog</p>

<p>të vazhdojë për shkak se i mituri refuzon të zbatojë masën apo arratiset, shërbimi sprovues menjëherë e njofton gjykatën dhe stacionin policor kompetent, të cilët të miturin e transportojnë në institucion.</p> <p>4. Mënyra e transportimit të të miturit në institucionin e kujdesit të posaçëm shëndetësorë nuk e cenon dinjitetin e tij. Zyrtari mjekësor e shoqëron të miturin gjatë transportimit të tij në institucionin e kujdesit të posaçëm shëndetësorë.</p> <p>5. Institucioni i kujdesit të posaçëm shëndetësor e informon shërbimin sprovues dhe gjykatën mbi përparimin e ekzekutimit të masës edukative.</p> <p>6. Institucioni veçanërisht e informon gjykatën për gjendjen shëndetësore të të miturit kur ai mbush moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet.</p>	<p>care facility cannot begin or continue because the juvenile refuses to comply with the educational measure or escapes, the Probation Service shall immediately inform the court and the competent police station, which shall transport the juvenile to the institution.</p> <p>4. The method of transporting the juvenile to the special health care facility shall not violate his dignity. A medical officer shall accompany the juvenile when he is being transported to the special health care facility.</p> <p>5. progress of the execution of the educational measure.</p> <p>6. The facility shall specially inform the court of the medical condition of the juvenile when he reaches the age of eighteen (18) years.</p>	<p>maloletnikovog odbijanja da izvrši vaspitnu meru ili zbog begstva, Probaciona Služba odmah obaveštava nadležni sud i nadležnu policijsku stanicu koja sprovodi maloletnika u ustanovu.</p> <p>4. Postupak transportovanja maloletnika u vaspitnu ustanovu ne povređuje njegovo dostojanstvo. Zdravstveni radnik prati maloletnika dok on biva transportovan u ustanovu sa posebnim medicinskim staranjem.</p> <p>5. Ustanova za posebno medicinsko staranje obaveštava nadležnu Probacionu službu i sud o napredovanju izvršenja vaspitne mere.</p> <p>6. Ustanova posebno obaveštava sud o zdravstvenom stanju maloletnika kada on navrši osamnaest (18) godina starosti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 93 Shqyrtimi, zëvendësimi dhe pushimi i masave edukative institucionale</p> <p>1. Çdo gjashtë (6) muaj, drejtori i institucionit apo qendrës, ku ekzekutohet masa edukative gjykata dhe shërbimit sprovues i dorëzon raport për sjelljen e të miturit dhe suksesin në ekzekutimin e masës. Varësisht nga sukcesi i ekzekutimit të masës,</p>	<p style="text-align: center;">Article 93 Review, Substitution and Termination of Institutional Educational Measures</p> <p>1. Every six (6) months, the director of the institution or facility where an institutional educational measure is executed shall submit to the court and the Probation Service a report on the behaviour of the juvenile and the success</p>	<p style="text-align: center;">Član 93 Preispitivanje, zamena i prestanak institucionalnih vaspitnih mera</p> <p>1. Svakih šest (6) meseci direktor institucije ili centra gde se izvršava vaspitna mera, podnosi nadležnom sudu i nadležnoj Probacionoj Službi izveštaj o ponašanju maloletnika i o uspešnosti izvršenja mere. Direktor, zavisno od uspeha izvršenja mere,</p>

<p>drejtori paraqet propozim për ndryshimin apo pushimin e ekzekutimit të masës edukative në pajtim me planin individual .</p> <p>2. Çdo gjashtë (6) muaj, gjykata e viziton të miturit e vendosur në institucion apo qendër, dhe përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me të miturit dhe zyrtarëve drejtpërdrejtë të përfshirë në ekzekutimin e masës edukative institucionale dhe pas shqyrtimit të shënimeve të institucionit apo qendrës, konstaton nëse të miturit trajtohen në mënyrë korrekte dhe në pajtim me ligjin, dhe nëse masat edukative institucionale kanë qenë të suksesshme.</p> <p>3. Nëse gjyqtari për të mitur me rastin e vizitës në qendrën edukuese korrektuese ku ekzekutohet masa ndaj të miturit vëren ndonjë parregullsi apo paligjshmeri menjëherë e njofton Inspektoratin për Mbikëqyrjen e institucioneve korrektuese, drejtorin e institucionit edukues- korrektues si dhe Drejtorin e përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Gjyqtari për të mitur duhet të njoftohet për masat e ndërrmara për evitimin e parregullsive dhe paligjshmëri.</p>	<p>in the execution of the measure. The director shall, depending on the success in the execution of the measure, submit a motion for amending or terminating the execution of the educational measure in compliance with the individual plan.</p> <p>2. Every six (6) months, the court shall visit the juveniles accommodated in an institution or facility and, through direct contact with the juveniles and the officers directly involved in executing institutional educational measures and reviewing the records of the institution or facility, establish whether the juveniles are treated correctly and in accordance with the law and whether the institutional educational measures have been successful.</p> <p>3. The juvenile judge shall immediately inform the Inspectorate for Supervision of Correction Institutions, Director of the educational-correctional institution as well as the General Director of Kosovo Correctional Service about any deficiencies or other observations when visiting the educational-correctional facility where the measure against the juvenile is being executed. The juvenile judge shall be informed of actions undertaken to correct illegalities and irregularities.</p>	<p>podnosi predlog za menjanje ili okončanje izvršenja vaspitne mere u skladu sa individualnim planom.</p> <p>2. Svakih šest (6) meseci, sud posećuje maloletnike smeštene u instituciju ili centar i u neposrednom kontaktu sa maloletnicima i službenicima koji su direktno uključeni u izvršenje institucionalnih vaspitnih mera, i preispitivanjem podataka institucije ili centra, ustanovljava jesu li maloletnici bili tretirani korektno i u skladu sa zakonikom i jesu li institucionalne vaspitne mere bile uspešne.</p> <p>3. Ako sudija za maloletnike tokom posete vaspitno - popravnoj ustanovi gde se sprovodi mera protiv maloletnika uoči bilo kakvu nepravilnost ili nezakonitost odmah o tome obaveštava Inspekciju za nadzor popravnih ustanova, Direktora vaspitno - popravne ustanove i Generalnog direktora Kosovske popravne službe. Sudija za maloletnike mora biti obavešten o preduzetim merama za sprečavanje nepravilnosti i nezakonitosti.</p>
--	--	--

<p align="center">Neni 94 Shqyrtimi i masës edukative institucionale</p>	<p align="center">Article 94 Review of Institutional Educational Measure</p>	<p align="center">Član 94 Preispitivanje institucionalne vaspitne mere</p>
<p>1. Gjykata që ka shqiptuar masën edukative shqyrton ekzekutimin e masës edukative çdo gjashtë (6) muaj.</p> <p>2. I mituri, prindi i tij, prindi adoptues apo kujdestari, qendra, institucioni apo vendi ku ekzekutohet masa edukative ose shërbimi sprovues mund të kërkojnë rishqyrtimin e ekzekutimit të masës edukative.</p> <p>3. Gjykata merr vendim për kërkesën të paraparë në paragrafin 2 të këtij neni brenda tetë (8) ditësh nga pranimi i kërkesës. Ankesa kundër këtij vendimi mund të dorëzohet në gjykatën e shkallës së dytë brenda tri (3) ditësh nga pranimi i vendimit.</p> <p>4. Gjatë shqyrtimit, gjykata i merr parasysh raportet e shërbimit sprovues dhe ato të drejtorit të institucionit apo qendrës ku një masë edukative institucionale ekzekutohet dhe dëgjon të miturin, prindin e tij, prindin adoptues a kujdestarin, avokatin mbrojtës, prokurorin dhe shërbimin sprovues.</p>	<p>1. The court that has imposed an educational measure shall review the execution of an educational measure every six (6) months.</p> <p>2. The juvenile, his parent, adoptive parent or guardian, the centre, institution or facility where the educational measure is executed or the Probation Service may request a review of the execution of an educational measure.</p> <p>3. The court shall issue a decision on the request referred to in paragraph 2 of the present Article within eight (8) days of the receipt of the request. An appeal against the decision may be filed with the court of second instance within three (3) days from receipt of the decision.</p> <p>4. During the review, the court shall consider the reports of the Probation Service and of the director of the institution or facility where an institutional educational measure is executed and shall hear the juvenile, his parent, adoptive parent or guardian, the defence counsel, prosecutor, and the Probation Service.</p>	<p>1. Nadležni sud koji je izrekao vaspitnu meru preispituje izvršenje vaspitne mere svakih šest (6) meseci.</p> <p>2. Maloletnik, njegov roditelj, usvojitelj ili staratelj, centar, ustanova ili objekat u kojem se izvršava vaspitna mera ili probaciona služba mogu da zahtevaju preispitivanje izvršenja vaspitne mere.</p> <p>3. Sudsko veće za maloletnike nadležnog suda donosi odluku o zahtevu o kojem je reč u paragrafu 2 iz ovog člana, u roku od osam (8) dana od prijema zahteva. Žalba protiv odluke može da bude uložena sudu druge instance u roku od tri (3) dana od prijema odluke.</p> <p>4. Tokom preispitivanja nadležni sud uzima u obzir izveštaje probacione službe i direktora institucije ili centra gde se institucionalna vaspitna mera izvršava i saslušava maloletnika, njegovog roditelja, usvojitelja ili staratelja, branioca, tužioca i probacionu službu.</p>

<p>5. Në bazë të rishqyrtimit, gjykata mund të vazhdojë apo të pushojë ekzekutimin e masës edukative apo atë ta zëvendësojë me një masë më të lehtë edukative.</p> <p>6. Përrjashtimisht nga paragrafi 5 i këtij neni, gjykata, masën edukative mund ta zëvendësojë me një masë më të rëndë edukative në rastin kur i mituri nuk i ka përmbushur detyrimet e posaçme të shqiptuara në pajtim me nenin 28 të këtij Kodi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 95 Pushimi dhe zëvendësimi i masës edukative institucionale</p> <p>1. Nëse pas marrjes së formës së prerë të vendimit mbi shqiptimit e masës edukative, zbulohen rrethana tjera, fakte të reja ose fakte që kanë ekzistuar por që nuk kanë qenë të njohura në kohën kur vendimi është marrë, e të cilat në mënyrë të qartë do të ndikonin në zgjedhjen e masës, gjykata shqyrton vendimin dhe mund të pushojë ekzekutimin e masës apo atë mund ta zëvendësojë me ndonjë masë tjetër edukative. Gjyqtari kompetent nuk mund tëshqiptojë masë më të rëndë në bazë të rishqyrtimit të provave të reja.</p> <p>2. Nëse ekzekutimi i masës edukative nuk ka filluar brenda një (1) viti nga data prej së</p>	<p>5. On the basis of the review, the court may decide to continue or terminate the execution of the educational measure, or substitute it for a less severe educational measure.</p> <p>6. As an exception to paragraph 5 of the present Article, the court may substitute an education measure with a more severe educational measure if the juvenile has failed to comply with a special obligation imposed pursuant to Article 28 of the present Code.</p> <p style="text-align: center;">Article 95 Termination and Substitution of the Institutional Educational Measure</p> <p>1. If, after a final ruling on imposing an educational measure has been rendered, additional circumstances, new evidence or evidence which existed but which was not known at the time the decision was rendered comes to light which would clearly have affected the selection of the measure, the court shall review the ruling and may terminate the execution of the measure or may substitute it with another educational measure. The competent judge may not impose a more severe measure on the basis of newly-considered evidence.</p> <p>2. If the execution of an educational measure has not commenced within one</p>	<p>5. Na osnovu preispitivanja, sud može da odluči da nastavi ili da okonča izvršenje vaspitne mere ili da je zameni blažom vaspitnom merom.</p> <p>6. Izuzeto od paragrafa 5 iz ovog člana, sud, vaspitnu meru može da zameni nekom težom vaspitnom merom u slučajevima kada maloletnik nije ispunio posebno izrečene zadatke u skladu sa članom 28 iz ovog Zakonika.</p> <p style="text-align: center;">Član 95 Obustava i zamena institucionalne vaspitne mere</p> <p>1. Ako, nakon donošenja rešenja o izricanju vaspitne mere budu obznanjene dodatne okolnosti, novi dokazi ili dokazi koji su postojali ali nisu bili poznati u vreme izricanja, a jasno je da bi uticali na izbor mere, sud preispituje rešenje i može da prekine izvršenje mere ili može da je zameni drugom vaspitnom merom. Nadležni sudija ne može da izrekne oštiju meru na osnovu novog razmatranja dokaza.</p> <p>2. Ako izvršenje vaspitne mere ne otpočne u roku od godinu dana od konačne odluke o</p>
---	---	--

<p>cilës vendimi mbi shqiptimin e masës bëhet i formës së prerë, gjykata rishqyrton vendimin dhe vendos për ekzekutimin apo pushimin e masës ose zëvendësimin e saj me ndonjë masë tjetër edukative. Gjykata nuk mund të shqiptojë masë më të rëndë.</p> <p>3. Rishqyrtimi i masës edukative në pajtim me këtë nen bëhet në pajtim me nenin 94 të këtij Kodi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 96 Ankesat dhe lutjet</p> <p>Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sankcioneve Penale lidhur me dorëzimin e ankesave dhe lutjeve nga personat e dënuar me burgim, vlejné përshtatshmërisht për dorëzimin e ankesave dhe lutjeve nga të miturit ndaj të cilëve janë duke u ekzekutuar masa edukative – korrektuese, apo dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm shëndetësorë.</p>	<p>(1) year from the date on which the decision imposing the measure becomes final, the court shall review the decision and decide whether to execute or to terminate the measure or to substitute it with another educational measure. The court may not impose a more severe measure.</p> <p>3. A review of an educational measure pursuant to the present Article shall be conducted in accordance with Article 94 of this Code.</p> <p style="text-align: center;">Article 96 Complaints and Petitions</p> <p>The provisions in the Law on Execution of Penal Sanctions on the submission of complaints and petitions by convicted persons sentenced to imprisonment shall apply mutatis mutandis to the submission of complaints and petitions by juveniles subject to the educational-correctional or committal to a special health care facility.</p>	<p>njenom izricanju, sud preispituje odluku i odlučuje dali da izvrši ili ukine meru ili da je zameni drugom vaspitnom merom. Sud ne može da izrekne oštriju meru.</p> <p>3. Preispitivanje vaspitne mere shodno ovom članu, se sprovodi prema članu 94 iz ovog Zakonika.</p> <p style="text-align: center;">Član 96 Žalbe i molbe</p> <p>Odredbe Zakonika o izvršenju krivičnih sankcija o podnošenju žalbi i molbi od strane lica osuđenih na kaznu zatvora primenjuju se, uz odgovarajuća priagođavanja na podnošenje žalbi i molbi od strane maloletnika koji izdržavaju vaspitnu meru upućivanja u disciplinski centar, upućivanja u vaspitnu instituciju, upućivanja u vaspitno-popravnu instituciju ili upućivanja u ustanovu za posebno zdravstveno staranje.</p>
---	--	---

KAPITULLI III - EKZEKUTIMI I DËNIMEVE	CHAPTER III - EXECUTION OF SENTENCES	POGLAVLJE III - IZVRŠENJE KAZNI
<p style="text-align: center;">Neni 97 Ekzekutimi i gjobës</p> <p>1. Dispozitat e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale lidhur me ekzekutimin e gjobës zbatohen përshtatshëm për ekzekutimin e gjobës të shqiptuara për të mitur.</p> <p>2. Gjoha e shqiptuar ndaj të miturit e cila nuk është paguar nuk mund të zëvendësohet me burgim.</p>	<p style="text-align: center;">Article 97 Execution of Fines</p> <p>1. The provisions in the applicable Law on Execution of Penal Sanctions on the execution of fines shall apply mutatis mutandis to the execution of fines imposed on juveniles.</p> <p>2. A fine imposed on a juvenile that is unpaid may not be replaced by a term of imprisonment.</p>	<p style="text-align: center;">Član 97 Izvršenje novčane kazne</p> <p>1. Odredbe Zakonika o izvršenju krivičnih sankcija o izvršavanju novčanih kazni primenjuju se uz odgovarajuća prilagođavanja na novčane kazne izrečene maloletnicima.</p> <p>2. Novčana kazna izrečena maloletniku a koju on ne plati, ne može da bude zamenjena kaznom zatvora.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 98 Ekzekutimi i urdhrin për punë në dobitë përgjithshme</p> <p>1. Dispozitat e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale për ekzekutimin e dënimit me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme zbatohen përshtatshëm për ekzekutimin e urdhrave për punë në dobi të përgjithshme të shqiptuara ndaj të miturve.</p> <p>2. Nëse është në interes të të miturit, shërbimi sprovues mund të kërkojë ndihmë apo bashkëpunim me organin e kujdestarisë apo përfaqësuesin ligjor të të miturit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 98 Execution of Orders for Community Service Work</p> <p>1. The provisions in the Law on Execution of Penal Sanctions on the execution of a sentence with an order for community service work shall apply mutatis mutandis to the execution of orders for community service work imposed on juveniles.</p> <p>2. If it is in the interest of the juvenile, the Probation Service may seek assistance from or cooperation with the Guardianship Authority or the legal representative of the juvenile.</p>	<p style="text-align: center;">Član 98 Izvršenje naloga za društveno koristan rad</p> <p>1. Odredbe Zakonika o izvršenju krivičnih sankcija o izvršenju uslovne kazne uz naređenje za društveno koristan rad primenjuju se uz odgovarajuća prilagođavanja, na izvršenje naređenja za društveno koristan rad izrečenog maloletniku.</p> <p>2. Ako je to u interesu maloletnika, probaciona služba može da zatraži pomoć ili saradnju organa starateljstva ili zakonskog zastupnika maloletnika.</p>

<p>3. Kujdes i veçantë duhet kushtuar që puna në dobi të përgjithshme të mos pengojë vijimin e rregullt në shkollë ose aktivitetet tjera të rëndësishme.</p> <p>4. Gjykata e cila e ka shqiptuar dënimin për punë në dobi të përgjithshme, zyrtarët e shërbimit sprovues i dorëzojnë raport me shkrim dhe e njoftojnë për çfarëdo pengese në ekzekutimin e kësaj mase.</p> <p>5. Nëse i mituri nuk mund të kryejë punën në dobi të përgjithshme për shkak të ndryshimit të mëvonshëm të rrethanave për të cilat ai nuk është përgjegjës, shërbimi sprovues nga gjykata kërkon rishqyrtimin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme.</p> <p>6. Varësisht nga rezultatet e arritura, gjykata mund ta ndryshojë urdhrin apo ta pushojë ekzekutimin e masës.</p>	<p>3. Special attention should be paid to ensuring that the completion of community service work does not prevent regular school attendance or other important activities.</p> <p>4. The Probation Service staff shall submit a written report to the court that has imposed the punishment on the performance of the community work and any obstacles in the execution of this measure.</p> <p>5. If the juvenile cannot complete the community service work because of a subsequent change in circumstances for which he is not responsible, the Probation Service shall ask the court to review the order for community service work.</p> <p>6. The court may, in view of the results achieved, amend the order or terminate the execution of the measure.</p>	<p>3. Naročita pažnja mora da bude posvećena tome da izvršavanje društveno korisnog rada ne sprečava redovno pohađanje škole ili druge značajne aktivnosti.</p> <p>4. Sudu koji je izrekao kaznu o društveno korisnom radu, službenici probacione službe podnose pisani izveštaj obaveštavaju ga o bilo kojoj smetnji u izvršavanju ove mere.</p> <p>5. Ako maloletnik ne može da dovrši društveno koristan rad zbog naknadne izmene prilika za koju on nije odgovoran, probaciona služba od suda zahteva da preispita naređenje za društveno koristan rad.</p> <p>6. Zavisno od postignutih rezultata, sud može da izmeni naređenje ili da obustavi izvršenje mere.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 99 Ekzekutimi i burgut për të mitur</p> <p>1. Dispozitat e këtij Kodi që rregullojnë dërgimin, pranimin, qëndrimin dhe shtyrjen e ekzekutimit, caktimin e grupeve arsimore, të drejtat në vizitë dhe angazhimin në ushtrime fizike, përcaktimin e punës dhe edukimin, mundësinë e shkollimit të rregullt, dënimet disiplinore të të miturve në</p>	<p style="text-align: center;">Article 99 Execution of Juvenile Imprisonment</p> <p>1. The provisions of the present Code regulating sending, admission, stay and suspension of execution, allocation to educational groups, rights to visit and participation in physical exercise, determination of work and education, the possibility of regular schooling,</p>	<p style="text-align: center;">Član 99 Izvršenje zatvora za maloletnike</p> <p>1. Odrebe ovog Zakonika koje regulišu upućivanje, prijem, boravak i obustavljanje izvršenja, smeštanje u vaspitne grupe, pravo na posete i fizičku rekreaciju, propisivanje rada i vaspitanja, mogućnost redovnog školovanja, disciplinske kazne maloletnika u vaspitno-popravnim ustanovama i postupci</p>

<p>institucionet edukative dhe procedurat për ankesa dhe lutje, gjithashtu vlejné edhe për ekzekutimin e dënimeve me burg për të miturit.</p> <p>2. Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për ekzekutimin e dënimit me burgim zbatohen përshtatshmërisht për ekzekutimin e dënimit me burgim për të mitur në rastet kur nuk janë në kundërshtim me këtë Kod.</p> <p>3. I mituri i cili është dënuar me burgim për të mitur, krahas të drejtave të parapara me këtë Kod, gëzon të njëjtat të drejta si personi madhor i dënuar me burgim.</p>	<p>disciplinary punishment of juveniles in educational institutions and procedures for complaints and petitions shall also be applied to the execution of the punishment of juvenile imprisonment.</p> <p>2. The provisions in the Law on Execution of Penal Sanctions on the execution of a sentence of imprisonment shall apply mutatis mutandis to the execution of juvenile imprisonment where they are not in conflict with the present Code.</p> <p>3. A juvenile who has been sentenced to juvenile imprisonment shall have the same rights as an adult who is sentenced to imprisonment in addition to the rights provided for by the present Code.</p>	<p>za žalbe i molbe, moraju takođe da važe i za izvršenje kazne maloletničkog zatvora.</p> <p>2. Odredbe Zakonika o izvršenju krivičnih sankcija za izvršenje kazne zatvora primenjuju se uz odgovarajuća prilagođavanja na izvršenje maloletničkog zatvora kad nisu u suprotnosti sa ovim Zakonikom.</p> <p>3. Maloletnik koji je kažnjen maloletničkim zatvorom ima ista prava kao punoletno lice kažnjeno zatvorom uz prava koja utvrđuje ovaj Zakonik.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 100 Aftësimi profesional dhe punësimi</p> <p>1. Gjatë kohës së mbajtjes së dënimit, të miturve u ofrohet aftësim i duhur profesional i bazuar në njohuritë e tyre, shkathtësitë, interesimet dhe punën që është duke e kryer, varësisht prej mundësive të institucionit korrektues. Bazat e trajtimit përfshijnë punën e dobishme edukative me shpërblim përkatës, lehtësimin dhe inkurajimin e kontakteve me jashtë të të miturve përmes letrave, telefonit, pranimit e vizitave, vizitave në shtëpi, aktiviteteve sportive dhe</p>	<p style="text-align: center;">Article 100 Vocational Training and Employment</p> <p>1. During the time they serve their sentences, juveniles shall be provided with appropriate vocational training based on their knowledge, skills, interests and current work, and depending on the limits of the correctional facility. The bases of the treatment are involvement in work that is educationally beneficial and with an appropriate remuneration, facilitating and encouraging contacts between the juvenile and the outside</p>	<p style="text-align: center;">Član 100 Profesionalno osposobljavanje i zapošljavanje</p> <p>1. Tokom izdržavanja kazne maloletnicima biva obezbeđeno profesionano osposobljavanje zasnovano na njihovom znanju, sposobnostima, interesovanjima i tekućem radu u skladu sa mogućnostima popravnihih institucija. Osnov ovog tretmana je uključivanje u rad koji je vaspitno koristan i uz odgovarajuću naknadu, olakšavajući i ohrabrujući kontakte između maloletnika i spoljašnjeg sveta putem pisama, telefona, primanja poseta, odlaženja u posetu kući,</p>

<p>ofrimit të kushteve të nevojshme për kryerjen e ritualeve fetare.</p> <p>2. Staf i profesional i shërbimit që trajton të miturit duhet të ketë trajnim adekuat për qasje dhe punën me fëmijë dhe njohuri të duhura nga lëmi i pedagogjisë dhe psikologjisë.</p>	<p>world through letters, telephone, receiving visits, going on home visits, sports activities and providing necessary conditions for religious practice.</p> <p>2. The professional staff of the service treating the juvenile shall have an adequate training regarding the approach and working with children and required knowledge in the fields of pedagogy and psychology.</p>	<p>sportskih aktivnosti i obezbeđivanja neophodnih uslova za vršenje verskih rituala.</p> <p>2. Profesionalno osoblje službe u čijoj je nadležnosti maloletnik, mora da ima odgovarajuće znanje iz pedagogije i psihologije.</p>
